

URDHËR
Nr. 7, datë 1.2.2013

PËR REVOKIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT TË FINANCAVE NR. 2, DATË 3.12.2004 “PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT ARAB YASIN AL-QADI I NJOHUR DHE SI: A) SHAYKH YASSIN ABDULLAH B) YASIN KAHDI C) YASSIN KADI Ç) KADI JASSIN D) YASSIN ABDULLAH KADI”

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër terrorizmit”, ligjit nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999, datë 29.10.2004, si dhe të vendimit nr. 936, datë 26.12.2012 “Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar” të Këshillit të Ministrave

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 2 të datës 3.12.2004 “Për sekuestrimin e asetëve të shtetasit arab YASIN AL-QADI i njohur dhe si: A) SHAYKH YASSIN ABDULLAH B) YASIN KAHDI C) YASSIN KADI Ç) KADI JASSIN D) YASSIN ABDULLAH KADI” të Ministrit të Financave, i ndryshuar me urdhrat nr. 27, datë 5.7.2006 dhe nr. 36, datë 27.11.2006.

2. Ky revokim përfshin të gjitha fondet, llogaritë, asetet, pasuritë e paluajtshme, trojet, investimet në shoqëri tregtare dhe mjetet financiare në emër të shtetasit YASIN AL-QADI të sekuestruara me urdhrat e mësipërm.

3. Për dorëzimin e pasurive të revokuara me këtë urdhër, të ngrihet një grup pune në përbërje të të cilit të ketë një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për kthimin e pasurive të identifikuar dhe të marra në dorëzim, si dhe të ardhurave të siguruar nga administrimi i tyre, pasi t’i zbriten shpenzimet e lejuara.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode